



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr. 731/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në rrjetin social Facebook dhe në media lokale, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale, që do të mbahen më datë 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e palejuar ankesa Anr.731/2021 e datës 02.11.2021, Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK), paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në Facebook dhe Media lokale, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale, që do të mbahen më datë 14.11.2021.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 02.11.2021 ka pranuar ankesën Anr.731/2021, të paraqitur nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, në të cilën pretendohet se me datë 29.10.2021, kandidati për Kryetar Komune, Ilir Ferati, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Istog, ka zhvilluar një aktivitet politik të cilin e ka publikuar në rrjetin social facebook të cilën e ka shpërndarë edhe në media lokale ‘RTV’ “Fontana” me mbishkrimin *Hapësira e sponsorizuar me pagesë nga (LDK)*. Paraqitësi i ankesës konsideron se ky veprim bie ndesh me Ligjin për Zgjedhjet dhe planin operacional të KQZ-së, pasi që subjektet politike nuk kanë të drejtë të sponsorizojnë aktivitetet e tyre politike jashtë fushatës zgjedhore. Kërkon nga PZAP, që të ndërmerr të gjitha masat adekuate ligjore, dhe se subjekti politik LDK të ndëshkohet komfor ligjit.

Si provë kësaj ankesë i ka bashkangjitur, dy fotografi nga postimet në fjalë.

Në përgjigje në Ankesë të datës 02.11.2021 Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e kundërshton këtë pretendim ankimor ngase periudha për Raundin e Dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave e përcaktuar sipas KQZ-së fillon me datë 8

Nëntor dhe zgjatë deri me datë 12 Nëntor, si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluara para datës zyrtare të caktuara për fushatë zgjedhore, LDK propozon që ankesa në fjalë të hudhet poshtë si e palejuar nga ana e PZAP-së.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Sipas Nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Periudha për Raundin e Dytë të zgjedhjeve për kryetar të Komunave, e përcaktuar sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) fillon me datë 8 Nëntor dhe zgjatë deri me datë 12 Nëntor, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, Paneli vlerëson se ankesa në fjalë është e palejuar ngase me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe në dispozitat e nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.731/2021 më datën 03.11.2021

**Kryesuesi i Panelit  
Zyhdi Haziri**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

